



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM  
Nr. 1 datë 22.1.2020**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË NGRITJES SË KOMISIONIT TË  
PËRKOHSHËM (AD-HOC) PËR VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT  
TEKNIKO-LIGJORË TË PROCESIT TË AMTP**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 22.1.2020, me propozim të Kryetarit të Komisionit për Çështjet Ligjore, bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; neni 20 dhe 24 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshilli Bashkiak Shkodër",


**V E N D O S I:**

1. Të miratojë në parim ngritjen e një komisioni të përkohshëm (Ad-Hoc), për verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjorë të procesit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), si dhe lënia e rekomandimeve përkatëse.
2. Përbërja, numri i anëtarëve dhe funksionimi i këtij komisioni, do të përcaktohen në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

**Sekretar i Këshillit**

  
**Denis Lesha**

**KRYETARE**

  
**Briseta KADIJA**

